

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6680  
E martë, 16 gusht 2022  
çmimi 0.40

Kurti, shteteve perëndimore:  
Na ndihmoni që Kosova  
të anëtarësohet në BE  
dhe NATO | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

PRESIDENTI I SHQIPËRISË PRITET NË KOSOVË ME NDERIMET MË TË LARTA SHTETËRORE

## SHQIPËRIA DO TË JETË ZËDHËNËSE E INTERESAVE TË KOSOVËS

FAQE 4-5

*Presidenti i shqiptar: Asnjë raport i trilluar  
nuk mund ta njollosë UÇK-në*



Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, ka thënë se shteti shqiptar mbështet anëtarësimin e Kosovës në BE dhe NATO. Ai ka thënë se Shqipëria do të jetë zëdhënëse e Kosovës në OKB. "Shqipëria mbështet fuqimisht anëtarësimin e Kosovës në NATO dhe vlerëson se NATO-ja mbetet garante e paqes në rajon dhe aleate strategjike e Kosovës dhe Shqipërisë", ka

thënë Begaj në një konferencë për medie mbajtur me presidenten Osmani në Prishtinë. Po ashtu, Begaj ka kërkuar nga BE-ja që ta mbajë premtimin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Begaj në ditën e parë të vizitës zyrtare në Kosovë ka folur edhe për UÇK-në. Ai ka thënë se nuk ka raport që mund ta njollosë luftën dhe luftëtarët e UÇK-së

### AKTUALE



RAMA: HAPJA E NEGOCIATAVE ME  
BE-NË, MUNDËSI E SHKËLOYER PËR  
TË NDËRTUAR SHTET LIGJOR F. 3

OSMANI PËR BARTJEN E SHAMISË  
NË SHKOLLA: KUSH PRETENDON  
QË I SHKELEN TË DREJTAT  
T'I DREJTOHET KUSHTETUESËS F. 7

NAGAVCI: NUK DO TA LEJOJMË  
PLAGJIATURËN TE STAFI AKADEMIK F. 6

MOLLIQAJ PARALAJMËRON  
PROTESTA PËR SHKAK  
TË SHKURTIMEVE TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE F. 7

### EKONOMI



RUKIQI: REFUZUAM PROJEKTE  
STRATEGJIKE PËR ENERGJI ME  
ARGUMENTE TË KOTA F. 8

ATK-JA INKASON 416 MIJË E 250  
EURO BORXHE NGA BIZNESET F. 8

### SPORT

SHKËLQIMI I MALVINËS  
NË VITIN 2022 F. 9

## OPOZITA E AKUZON QEVERINË PËR KEQMENAXHIM TË ENERGJISË

FAQE 4-5

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Evropa goditet rëndë nga thatësira

**BERLIN, 15 GUSHT** - Thatësira e verës dhe temperaturat e larta po godasin me forcë çdo sektor në Evropë, nga bujqësia deri tek industria e transportit të mallrave.

Kompanitë e transportit lumor dhe ato të logjistikës në Gjermani do të ndërpresin për arsye sigurie shumicën e udhëtimeve të anijeve të transportit në lumin Rin. Kjo ndërprerje bëhet për shkak të rënies së nivelit të ujit. Meqenëse në ditët në vijim nuk priten reshje të konsiderueshme, parashikohet që nga fundjava niveli i ujit të lumit Rin të bjerë nën 40 cm dhe kjo e bën të pamundur lundrimin pa rrezik të anijeve të transportit.

Javët e fundit është duke rënë drejt niveleve kritike edhe sasia

e ujit në lumin Danub në Hungari, ndërkohë që pjesë të liqenit Velence, në jugperëndim të Budapestit, këtë javë u thanë tërësisht.

Zëvendësguvernatori i Bankës Qendrore të Hungarisë, Barnabas Virag, ka paralajmëruar se periudha e gjatë e thatësirës, e shoqëruar me ndikimin e luftës në Ukrainë ndaj furnizimit me drithëra dhe ushqime, mund ta shkaktojë rritjen e çmimeve të ushqimeve muajt e ardhshëm dhe ta përkeqësorë prirjen për inflacion me të cilën po përballet vendi.

Edhe Britania e Madhe po përjeton motin më të thatë prej më shumë se një shekull. Shërbimi kombëtar i motit e ka shpallur korrikun si muajin më të thatë për Anglinë që nga viti



1935, me reshje mesatare prej 23.1 milimetrash. Prej thatësirës edhe lumi Thames po përjeton një mungesë të paparë uji. Kurse në rajonin jugperëndimor të Burgundisë, në Francë, lumi Tille në fshatin Lux është tharë plotësisht. Në

shtratin e lumit kanë dalë në pah mijëra peshq të ngordhur. Për shkak të thatësirës Franca është detyruar të vendosë kufizime të ndryshme për përdorimin e ujit në mbarë vendin.

Moti i thatë i kombinuar me

inflacionin dhe konfliktin në Ukrainë po e përkeqësojnë edhe gjendjen e fermerëve në Evropën Perëndimore.

Presidenti i Shoqatës Gjermane të Fermerëve, Joachim Rukwied, ka paralajmëruar së fundi se, nëse nuk do të ketë reshje së shpejti, të korrat e këtij viti mund të preken rëndë nga vala e të nxehtit. "Për momentin ne po luftojmë në shumë fronte. Çmimet e plehrave kimikë janë katër herë më të larta se një vit më parë. Çmimet e energjisë janë dy herë më të larta. Çmimet e ushqimit për kafshë janë rritur", ka thënë Rukwied për "DPA"-në, duke shtuar se "nëse nuk bie shi së shpejti, atëherë kemi frikë se rendimentet e të korrave mund të reduktohen deri në 30 për qind ose 40 për qind".

## Dhjetëra shtete kërkojnë që Rusia t'i tërheqë trupat nga Zaporizhja

**BRUKSEL, 15 GUSHT** - Dyzet e dy shtete nga e mbarë bota kanë nënshkruar një deklaratë përmes së cilës i bëjnë thirrje Rusisë që t'i tërheqë trupat nga centrali bërthamor i Zaporizhjas. Këto shtete kanë thënë se prania e trupave ruse në këtë central ukrainas përbën "rrezik të madh".

Deklarata, që është publikuar nga Bashkimi Evropian (BE), dënon pushtimin e paprovokuar rus të Ukrainës, duke thënë se prania e forcave ushtarake ruse në central, pengon autoritetet që ta mirëmbajnë këtë uzinë dhe t'i respektojnë rregullat e sigurisë nga rrezatimi. Centrali i Zaporizhjas është më i madhi në Evropë. "Është e pamohueshme që pushtimi i Rusisë dhe prania e saj e vazhdueshme në ndërtesat



bërthamore rrit ndjeshëm rrezikun e incidenteve dhe aksidenteve bërthamore. Ne i bëjmë thirrje Federatës Ruse që menjëherë t'i tërheqë trupat e saj dhe personelin e paautorizuar nga centrali i Zaporizhjas dhe të gjithë operatorët dhe autoritetet ukrainase të mund t'i rinisin

përgjegjësitë e tyre sovraane brenda kufijve të Ukrainës të njohur ndërkombëtarisht", është thënë në deklaratën e BE-së.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky gjatë fundjavës së kaluar ka paralajmëruar se granatimet e fundit në central kanë rritur rrezikun e rrjedhjes

së rrezatimit.

Rusia nuk e ka mohuar se trupat e saj gjenden në central, por hedh poshtë pretendimet se ka granatuar këtë zonë. Në vend të kësaj, Moska ka akuzuar forcat ukrainase se kanë goditur zonën me artileri, pretendime që mohohen nga Kievi.

Situata në central ka rritur alarmin në Kombet e Bashkuara dhe në Agjencinë Ndërkombëtare për Energji Bërthamore. Si OKB-ja, ashtu edhe kjo agjenci, kanë thënë se ekspertët ndërkombëtarë duhet të lejohen që ta vizitojnë centralin. Ndërsa sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres, ka bërë thirrje për çmilitarizimin e zonës. "Dislokimi i personelit ushtarak dhe armatimit në ndërtesën bërthamore është i

papranueshëm dhe shpërfill rregullat e sigurisë dhe masave mbrojtëse të cilat anëtarët e Agjencisë Ndërkombëtare për Energji Bërthamore janë zotuar që t'i respektojnë", është thënë në deklaratë.

Deklarata është nënshkruar nga: Australia, Austria, Belgjika, Bullgaria, Kanadaja, Kroacia, Qiproja, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjeorgjia, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Irlanda, Italia, Japonia, Letonia, Litenshtajni, Lutanja, Luksemburgu, Malta, Mali i Zi, Norvegjia, Zelanda e Re, Maqedonia e Veriut, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Koreja, Moldavia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Turqia, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara si dhe Bashkimi Evropian.

## Shitja e "Bayraktar"-it, porositë e mbyllura për tri vjet

**ANKARA, 15 GUSHT** - Duket se kërkesa për dronët turq "Bayraktar TB2" është rritur ndjeshëm. Kompania turke "Baykar Makina Sanayi ve Ticaret AS", e cila furnizon Ukrainën me dronë, ka njoftuar se aktualisht ka një numër të madh të porosive për tri vjet. Sipas kompanisë, ajo ka kapacitetin për të prodhuar 20 dronë në muaj.

"Dronët 'TB2' dhe 'Akinci' janë prodhuar në masë. Ne kemi kërkesë për të dyja. Për 'Bayraktar TB2' kemi kontrata eksporti me 22 vende të ndryshme", ka thënë menaxheri i kompanisë private Haluk

Bayraktar në një intervistë për fondacionin ukrainas "Come Back Alive".

Bayraktari, i cili po punon në një projekt luftarak pa pilot të quajtur "Bayraktar Kizilelma", ka thënë se dëshiron të rrisë kapacitetin e tij prodhues dhe shpreson ta bëjë këtë duke ndërtuar një fabrikë në Ukrainë. Kujtojmë se kompania turke ka blerë tokë në Ukrainë dhe është regjistruar si person juridik me qëllim të ndërtimit të një fabrike për prodhimin e mjeteve ajrore pa pilot "Bayraktar".

Bayraktar, i cili është vëllai i dhëndrit të presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan, Selcuk



Bayraktar, ka thënë se kompania "TB2", "Akinci" dhe "Kizilelma" dëshiron të ndërtojë dronë Fighters" në Ukrainë. Ndërtimi i

një objekti kërkimor dhe një qendre prodhimi të avancuar tashmë është duke u zhvilluar. "Ne e shohim Ukrainën si partneren tonë strategjike. Ne, gjithashtu, duam ta bëjmë Ukrainën një bazë prodhuese", ka thënë Bayraktari.

Siç ka raportuar "Bloomberg", Turqia ka arritur të mbajë marrëdhënie të mira si me Ukrainën ashtu edhe me Rusinë këtë vit. Edhe pse Turqia furnizon Ukrainën me dronë të armatosur, eksportet e këtij shteti në Rusi kanë arritur një nivel më të lartë tetëvjeçar prej 2.9 miliardë dollarësh në gjysmën e parë të 2022-s.



# Kurti, shteteve perëndimore: Na ndihmoni që Kosova të anëtarësohet në BE dhe NATO

PRISHTINË, 15 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka dhënë një intervistë për gazetën prestigjioze "Financial Times (FT)", përmes së cilës u ka kërkuar fuqive perëndimore ta ndihmojnë Kosovën që të arrijë ambicien e saj për t'u bashkuar me BE-në dhe NATO-n.

Kurti i ka bërë thirrje Perëndimit që t'i bindë qeveritë ngurruese ta njohin pavarësinë e Kosovës. Ai u ka kërkuar shteteve perëndimore të ushtrojnë presion ndaj qeverive që nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës, teksa ka kërkuar edhe zgjidhjen e tensioneve me Serbinë.

"Ne kemi nevojë për ndihmën e aleatëve dhe partnerëve tanë, Mbretërisë së Bashkuar, ShBA-së, Gjermanisë, Francës, Italisë dhe të tjerëve për të na ndihmuar të mosnjohësit", ka thënë Kurti.

Kosova e ka shpallur pavarësinë nga Serbia në vitin 2008. Që atëherë, më shumë se 100 vende, duke përfshirë ShBA-në dhe shumicën e anëtarëve të BE-së, e kanë njohur vendin si shtet të pavarur. Por, disa vende të BE-së dhe NATO-s si Spanja, Greqia, Qiproja, Sllovakia dhe Rumania ende nuk e kanë bërë këtë.

Ndërkohë, Beogradi vazhdon ta shohë Kosovën, popullsia e së cilës është rreth 90 për qind shqiptarë etnikë dhe më pak se 10 për qind serbë, si një krahinë e Serbisë.

Tensioni midis të dy shteteve kërcënon rregullisht ta minojë stabilitetin në Ballkan.

Çështjet në dukje të zakonshme kanë çuar në shpërthime të dhunshme, më së fundmi muajin e kaluar, kur serbët u përleshën me Policinë e Kosovës pasi Prishtina tha se targat serbe nuk do të ishin më të ligjshme për qytetarët e Kosovës, përfshirë serbët etnikë.

Individëve që hynin në Kosovë nga Serbia u është kërkuar ta përdornin letërnjoftimin e përkohshëm të lëshuar nga Prishtina. Kurti ka argumentuar se përplasjet janë të nxitura nga qeveria serbe. Beogradi ka mohuar përfshirjen. BE-ja kërkoi të dielën që "të dyja palët duhet t'u japin fund menjëherë armiqësisë të ndërsjella dhe deklaratave të rrezikshme dhe të veprojë me përgjegjësi" përpara bisedimeve midis rivalëve në Bruksel këtë javë.

Kurti, i cili ka folur me "FT" përpara se BE-ja të bënte thirrje për t'i dhënë fund përdorimit të retorikës nxitëse, është planifikuar të takohet me Vuçiçin të enjten kur ata do të diskutojnë për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe lidhjet dypalëshe. Kurti ka thënë se çdo rezolutë duhet të përqendrohet në njohjen reciproke.

Kurti i ka bërë thirrje Serbisë ta lë mënjanë nacionalizmin. "Këtu mendoj se është problemi me Beogradin. Ata thjesht vazhdojnë me ëndrrat e vjetra, të cilat bëhen makthe për fqinjët e Serbisë, por edhe për popullin serb. Një simetri e të drejtave të pakicave,



të njëjtat të drejta për serbët në Kosovë dhe kosovarët në Serbi do ta luftonte më së miri nacionalizmin", është shprehur Kurti.

Kurti ka thënë se pushtimi i plotë i Rusisë në Ukrainë në shkurt kishte nxjerrë në pah besnikërinë konfliktuale në Ballkan.

Ndërsa Kosova ishte ndër vendet e para që iu bashkua sanksioneve kundër Rusisë, Serbia ka lidhje të ngushta me Moskën. Sektori energjetik i vendit është shumë i varur nga burimet ruse dhe i ekspozuar ndaj shumicës së pronësisë ruse të kompanive kryesore. Beogradi mbështeti disa deklaratatë të OKB-së që mbështesin sovranitetin e Ukrainës pas pushtimit të Moskës në shkurt, por ajo nuk pranoi t'u bashkohej sanksioneve perëndimore kundër Rusisë dhe këmbënguli në mbajtjen e lidhjeve të ngushta me Kremlinin. Serbët ushqejnë pakënaqësi ndaj

Perëndimit për ndërhyrjen e NATO-s në luftën e Kosovës 1998-99, njohjen e Kosovës nga disa qeveri dhe një sërë vendimesh gjyqësore që thanë se shpallja e pavarësisë ishte në përputhje me ligjin ndërkombëtar, thonë analistët.

Kurti ka thënë se ekziston një rrezik i qartë i përfshirjes ruse në marrëdhëniet Serbi - Kosovë, duke rritur shanset për konflikt. "Ne jemi të shqetësuar, por jo të frikësuar. Si do të zhvillohet situata, do të varet shumë nga qëndrimi dhe presioni i demokracive perëndimore ndaj Beogradit", ka thënë Kurti.

Ndërsa Petar Petković, zyrtari më i lartë i qeverisë serbe për çështjet e Kosovës, ka thënë në një përgjigje me shkrim ndaj pyetjeve të FT-së, se Beogradi po ndiqte një "politikë të pavarur kombëtare dhe të sigurisë, duke bashkëpunuar në mënyrë të balancuar si me Lindjen ashtu

edhe me Perëndimin".

Qëllimi përfundimtar i Beogradit ishte anëtarësimi në BE, ka thënë ai, por ka shtruar se Kosova dhe Kurti po shtynin një agjendë nën "pretekstin" e luftës në Ukrainë. Megjithatë, Kurti ka thënë: "Ajo që dëshiron Serbia është t'i marrë fondet e BE-së, armët ruse, investimet kineze dhe tolerancën amerikane. Nëse demokracitë perëndimore nuk e lejojnë këtë, një zgjidhje do të jetë shumë e lehtë për t'u arritur. Por nëse (serbët) lejohen të luajnë këtë lojë, ky tension do të vazhdojë".

Duke iu referuar ish-udhëheqësit serb Slobodan Millosheviq, i cili ka udhëhequr forcat serbe në një seri luftërash brutale pas rënies së ish-Jugosllavisë në vitet 1990, Kurti ka thënë se që të arrihet përparim, "është shumë e rëndësishme që (serbët) ta emancipojnë veten e tyre nga Millosheviqi dhe nga presidenti rus Vladimir Putin". Nacionalizmi serb dhe interesat ruse kanë shkuar krah për krah, ka thënë Kurti. "Është e njëjta gjë", ka thënë Kurti, duke vënë në dukje se zbrëthimi i njëjës do ta dobësonte tjetrin. Udhëheqësi i Kosovës ka thënë se edhe pse Prishtina punon për anëtarësim në NATO, vendi i tij synon ta përmirësojë sistemin e saj ekonomik, ligjor dhe institucional për të treguar se ndërhyrja e NATO-s në vitin 1999 kishte krijuar një shtet të qëndrueshëm që ishte një aleat besnik perëndimor.

## Rama: Hapja e negociatave me BE-në, mundësi e shkëlqyer për të ndërtuar shtet ligjor

TRANË, 15 GUSHT - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në një intervistë për median franceze "Francesoir", ka thënë se "hapja e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE) është një mundësi e shkëlqyer për të ndërtuar një shtet ligjor, një shtet demokratik që funksionon edhe më mirë dhe u garanton qytetarëve standarde që nuk varen nga njëri apo tjetri, por nga shteti". "Hapja e negociatave këtë verë është një lajm shumë i mirë për ne. Kjo na ndihmon të



përparojmë. Kur negociohet anëtarësimi në Bashkimin Evropian, krijohet edhe mundësia që të kryhet një proces shumë i thellë mbi vetveten tonë, sepse është një proces shumë i detajuar mbi ligjet, institucionet, funksionimin e tyre si dhe përmirësimet që u duhen bërë këtyre komponentëve", ka thënë Rama, duke shtuar se dikur Shqipëria ishte si Koreja e Veriut. "Këto janë çështje në diskutim, por ajo çfarë ndryshon që tani, është mënyra e të punuarit, të të

imagjinuarit e ndërtuarit të ardhmen. Bëhet fjalë për ndërtimin e një shteti që nuk e kemi pasur kurrë më parë. Deri më tani nuk e kemi njohur shtetin e ligjit, shtetin e bërë enkas për qytetarin, ku gjykatësi është gjykatës, dhe pushteti është i ndarë si duhet. Ky është një ndryshim. Për më tepër, Shqipëria ka qenë vendi më i izoluar nga vendet komuniste. Ne nuk kishim marrëdhënie e shkëmbime, madje as me vendet e Lindjes që i përkisnin dikur bllokut komunist.

Ne ishim Koreja e Veriut e Evropës. Ky është një ndryshim thelbësor shumë i thellë", ka deklaruar Rama.

Më tutje, Rama ka thënë se beson se pas 10 vjetësh Shqipëria do të jetë anëtare e BE-së. "Pas 10 vjetësh ndoshta do të jetë në BE, nëse BE-ja mbetet siç është tani. Në fakt, bota sot ndryshon shumë shpejt, mjafton ta shihni situatën aktuale. Pa tragedi, pas 10 vjetësh, Shqipëria do të jetë në BE dhe ne do të bëjmë gjithçka për ta arritur këtë", ka thënë Rama.

## Vuçiçi: Ruajtja e paqes dhe stabilitetit, qëllimi i takimit me Kurtin

BEOGRAD, 15 GUSHT - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiçi, ka thënë se qëllimi i vetëm i takimit të 18 gushtit në Bruksel me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, është të ruhen paqja dhe stabiliteti.

Vuçiçi u ka thënë gazetarëve se Beogradi "nuk kërcënon askënd me asgjë", por vetëm dëshiron të sigurohet se po respektohen rregullat ndërkombëtare dhe normat juridike publike. "Ato janë marrëveshje të cilat janë të vlefshme dhe në fuqi, dhe duhet

të respektohen dhe zbatohen", ka thënë ai.

Siç ka raportuar agjencia serbe e lajmeve "Beta", Vuçiçi ka thënë se këtu përfshihet respektimi i Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe marrëveshja e Brukselit.

Vuçiçi ka folur edhe për çështjen e targave të makinave që përdoren nga serbët në Kosovë, e të cilat Prishtina po kërkon të zëvendësohen nga targat RKS (Republika e

Kosovës). "Nëse dikush dëshiron ta bëjë këtë me forcë, ju mund të bëni gjithçka me forcë. Do të flasim për gjithçka, por a do të kenë këto bisedime ndonjë kuptim, për çka unë dua të besoj, do ta shohim pas dy-tre ditësh" ka thënë ai.

Presidenti i Serbisë nuk ka dashur ta komentojë një deklaratë të Bashkimit Evropian që më 14 gusht shprehu shqetësimin lidhur me rritjen e retorikës nxitëse nga zyrtarët e Beogradit dhe Prishtinës.







PRESIDENTI I SHQIPËRISË PRITET NË KOSOVË ME NDERIMET MË TË LARTA SHTETËRORE

# Shqipëria do të jetë zëdhënëse e interesave të Kosovës

## Presidenti i shqiptar: Asnjë raport i trilluar nuk mund ta njollojë UÇK-në

Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, ka thënë se shteti shqiptar mbështet anëtarësimin e Kosovës në BE dhe NATO. Ai ka thënë se Shqipëria do të jetë zëdhënëse e Kosovës në OKB. “Shqipëria mbështet fuqimisht anëtarësimin e Kosovës në NATO dhe vlerëson se NATO-ja mbetet garante e paqes në rajon dhe aleate strategjike e Kosovës dhe Shqipërisë”, ka thënë Begaj në një konferencë për medie mbajtur me presidenten Osmani në Prishtinë. Po ashtu, Begaj ka kërkuar nga BE-ja që ta mbajë premtimin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Begaj në ditën e parë të vizitës zyrtare në Kosovë ka folur edhe për UÇK-në. Ai ka thënë se nuk ka raport që mund ta njollojë luftën dhe luftëtarët e UÇK-së

BE-ja. “Liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës është një premtim i vonuar. Unë e sigurova presidenten Osmani për mbështetjen e Shqipërisë për liberalizimin e vizave për Kosovën”, ka thënë Begaj.

Më tutje, presidenti Begaj ka folur edhe për situatën e tensionuar në veri të Kosovës. Ai ka thënë se Kosova ka shprehur maturi në tensionet e fundit në veri të Kosovës më 31 korrik dhe 1 gusht, kur serbët lokalë kishin bllokuar rrugët për ta shprehur kundërshtimin

e tyre për vendimet e Kosovës për targarat dhe dokumentet serbe. Presidenti shqiptar ka thënë se dialogu i ndërmjetësuar nga BE-ja midis Kosovës dhe Serbisë është mënyra e vetme për t’ia bërë të qartë Serbisë se “realiteti i Kosovës së pavarur është i pakthyeshëm dhe i pandryshueshëm”. “Formula e zgjidhjes së dialogut Kosovë - Serbi, e shprehur nga presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, si marrëveshje gjithëpërfshirëse

për normalizimin e marrëdhënieve e fokusuar në njohje reciproke. Apo qëndrimi i përsëritur i kancelarit gjerman, Olaf Scholz, se njohja e pavarësisë së Kosovës nga Serbia është kusht për anëtarësimin e Serbisë në BE, janë inkurajuese në përpjekjet tona që rezultati përfundimtar të jetë një: marrëveshje e detyrueshme ligjore që përcakton saktësisht njohjen e ndërsjellë, anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe BE, si dhe trajtimin e drejtë të

**EPOKA  
ERE****Lirim GECI**

**PRISHTINË, 15 GUSHT** - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj, me ftesë të homologes Vjosa Osmani, ka filluar të hënën vizitën e parë zyrtare në Republikën e Kosovës. Begaj është pritur nga Osmani me nderimet më të larta shtetërore. Pas takimit, Begaj dhe Osmani kanë mbajtur një konferencë të përbashkët për medie.

Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, ka thënë se i ofron

Kosovës mbështetjen e shtetit shqiptar në të gjitha fushat. Në këtë kontekst, Begaj ka thënë se Kosova e ka mbështetjen e plotë të Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE) dhe në NATO. “Shqipëria mbështet fuqimisht anëtarësimin e Kosovës në NATO dhe vlerëson se NATO-ja mbetet garante e paqes në rajon dhe aleate strategjike e Kosovës dhe Shqipërisë”, ka thënë presidenti Begaj.

Begaj ka thënë se liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës është një premtim i vonuar nga





minoriteteve sipas Kushtetutës së Kosovës”, ka thënë Begaj, duke e siguruar Osmanin se Tirana nuk mund ta mbështesë ushtarakisht, por vetëm politikisht Kosovën. “E sigurova presidenten Osmani se gjatë mandatit në Këshillin e Sigurimit dhe si anëtare e OKB-së, Shqipëria do të jetë zëdhënëse e interesave të Kosovës, përfunduese e zërit të saj për promovimin e shtetit të pavarur të Kosovës, pathyeshmërinë e këtij fakti, njohjet e reja dhe rrugëtimin e saj euroatlantik”, ka thënë Begaj.

### Osmani: BE-ja të jetë më e zëshme karshi tendencave destabilizuese serbe

Ndërsa presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se me presidentin Bajram Begaj do të punojnë ngushtë për ta avancuar rrugëtimin evropian të shteteve tona, për ta fuqizuar zërin tonë kudo në botë dhe për të qëndruar bashkërisht në mbrojtjen e demokracisë, paqes dhe lirisë. “Kjo vizitë e rëndësishme vazhdon traditën e presidentëve nga Shqipëria, të cilët e nisnin mandatin e tyre me vizitën në Kosovë si konfirmim i mbështetjes së pazërvë për Republikën e Kosovës, si dhe përkushtimin e ndërsjellë për t’i thelluar raportet tona si shtete simotra”, ka thënë Osmani.

Në vazhdim të fjalës së saj, Osmani është ndalur edhe te raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ajo ka thënë se Kosova dhe Serbia nuk mund të trajtohen njëjtë kur bëhet fjalë për përdorimin e retorikës luftënxitëse, teksa ka kërkuar nga Bashkimi Evropian (BE) të reagojë ndaj “tendencave destabilizuese të Serbisë”.

Ky reagim i Osmanit vjen një ditë pasi BE-ja u ka bërë thirrje liderëve në Kosovë dhe Serbi t’i japin fund retorikës nxitëse pasi tha se “do t’i mbajë përgjegjës liderët politikë për çfarëdo përshkallëzimi të situatës në rajon”. “Ne presim që Bashkimi Evropian të jetë më i zëshëm karshi tendencave

destabilizuese të Serbisë ndaj gjithë rajonit, tendenca këto që janë të nxitura dhe u shërbejnë interesave të Rusisë. Nuk ka dhe nuk mund të ketë ekuivalencë të trajtimit të palëve kur qartazi Serbia është agresorja dhe është ajo që po përdor retorikë luftënxitëse në raport me Kosovën. Por, edhe veprime të cilat cenojnë paqen dhe stabilitetin ndaj Kosovës”, ka thënë Osmani, duke shtuar se është koha për një traktat me Shqipërinë për të reaguuar në rast të cenimit të dy shteteve. “Është me rëndësi që me Shqipërinë, siç diskutuam, të kemi një traktat për mbrojtje të ndërsjellë, me të cilin në mënyrë reciproke do të reagojmë në rast të cenimit të dy shteteve tona”, ka thënë Osmani.


Presidentja ka thënë se kjo praktikë “është në harmoni me praktikën ndërkombëtare dhe aplikohet nga shumë shtete”. “Është koha që të bëjmë hapa të duhur në këtë drejtim”, ka thënë ajo.

Kosova, siç ka thënë presidentja Osmani, llogaritet në Shqipërinë dhe ajo i ka thënë Begajt se ka besim që nën udhëheqjen e tij do të shtohet marrëdhëniet ndërshtetërore. “Fakti që Shqipëria tashmë është anëtare e NATO-s, krijon siguri më të madhe në gjithë rajonin tonë. Në këtë kohë kur po sfidohet arkitektura e sigurisë, siguria është shndërruar në prioritet”, ka thënë Osmani.

Presidenti i Shqipërisë në ditën e parë të vizitës zyrtare në Kosovë ka bërë homazhe te varri i ish-presidentit Ibrahim Rugova, ku ka vlerësuar lart kontributin e tij për pavarësinë e Kosovës. Po ashtu, Begaj ka bërë homazhe në kompleksin memorial “Adem Jashari”, ku ka vlerësuar lart sakrificën e familjes Jashari për lirinë e Kosovës.

### Konjufca falënderon Shqipërinë për mbështetjen

Pas takimit me Osmanin, presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, është takuar me



kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca. Në takim është diskutuar për zhvillimet aktuale politike, për agresionin rus në Ukrainë, si dhe për thellimin e bashkëpunimit dhe shtimin e intensitetit të aktiviteteve ndërinstitucionale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Kryekuvendari Konjufca e ka uruar Begajn për zgjedhjen president të Shqipërisë, duke i dëshiruar suksese në këtë detyrë të rëndësishme shtetërore.

Kryetari Konjufca ka shprehur mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme të shtetit të Shqipërisë ndaj Kosovës, në veçanti për mbështetjen gjatë kohës së luftës. Me rastin e vizitës së tij të parë në Kosovë, presidenti Begaj e ka falënderuar Konjufcën për pritjen dhe ka konfirmuar mbështetjen e Shqipërisë për Kosovën, për proceset e anëtarësimit të saj në BE, në NATO, si dhe në organizatat ndërkombëtare.

Kryetari Konjufca dhe presidenti Begaj i kanë vlerësuar të shkëlqyera raportet ndërmjet dy shteteve. Presidenti Begaj të hënën është takuar edhe me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, me të cilin ka biseduar për raportet në mes të dy shteteve dhe zhvillimet në rajon. “E urova për zgjedhjen dhe ofrova bashkëpunimin tim për interesat tona të

## Presidenti i Shqipërisë: Asnjë raport i trilluar nuk mund ta njollojë UÇK-në

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj, në konferencën e përbashkët për medie me homologen Vjosa Osmani, ka folur edhe për rolin historik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Ai ka thënë se UÇK-ja është faqe e ndritur e çdo shqiptari. Duke iu referuar raportit të Dick Martyt, Begaj ka thënë asnjë raport i trilluar nuk mund ta njollojë UÇK-në, udhëheqësit dhe luftëtarët e saj. “UÇK-ja përbën një faqe të ndritur për historinë sonë të përbashkët. UÇK-ja bën krenar çdo shqiptar. Asnjë raport i trilluar që tenton ta njollojë gjakun dhe vetëflijimin e shqiptarëve në mbrojtje të lirisë, flamurit dhe identitetit kombëtar nuk

do të arrijë kurrë ta zbehë këtë trashëgimi të lavdishme”, ka thënë Begaj.

Gjykata Speciale është krijuar mbi bazën e raportit të Dick Martyt, ku nga nëntori i vitit 2020 janë duke u mbajtur në paraburgim drejtuesit kryesorë të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi.

Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi qysh në daljen e parë para trupit gjykues janë deklaruar të pafajshëm në lidhje me akuzat e prokurorisë. Përpos tyre, në qendrën e paraburgimit në Hagë janë duke u mbajtur edhe Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, Sali Mustafa dhe Pjetër Shala.

përbashkëta në dobi të popullit dhe qytetarëve tanë, demokracisë, përparimit dhe sigurisë”, ka shkruar Kurti në “Twitter”.

Presidenti shqiptar sot (e martë) do të takohet edhe me kryetarin e PDK-së, Memli

Krasniqi, atë të LDK-së, Lumir Abdixhiku dhe liderin e AAK-së, Ramush Haradinaj. Begaj do ta përmbyllë vizitën dyditore në Prizren, ku do ta vizitojë Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe do të takohet me kryetarin e qytetit historik, Shaqir Totaj.





# Nagavci: Nuk do ta lejojmë plagjiaturën tek stafi akademik

PRISHTINË, 15 GUSHT (ER) - Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka nënshkruar vendimin për pajtueshmërinë e punimeve dhe publikimeve shkencore me etikën në hulumtim të stafit akademik të institucioneve të arsimit të lartë (IAL).

Sipas këtij vendimi, obligohen të gjitha IAL-të në Republikën e Kosovës që me rastin e deklarimit të stafit akademik në platformën e-akreditimi të AKA-së ta bëjnë ngarkimin e disertacionit të doktoratës dhe të publikimeve në revistat e indeksuara, në platformat e përcaktuara me manualin e AKA-së për akreditim.

Me këtë rast, Nagavci ka thënë se ky vendim obligon zbatimin e përpiktë të standardeve evropiane të cilësish të cilat thonë se institucionet (e arsimit të lartë) kanë politika dhe procese që garantojnë dhe

përmirësojnë cilësinë e aktiviteteve të tyre si hulumtimi dhe qeverisja.

“Ndonëse plagjiatura konsiderohet formë e rëndë e shkeljes së etikës akademike, fatkeqësisht raste të tilla u raportuan së fundi në Universitetin e Prishtinës. Në linjë me këtë kam nënshkruar sot vendimin për pajtueshmërinë e punimeve dhe publikimeve shkencore me etikën në hulumtim të stafit akademik të institucioneve të arsimit të lartë (IAL). Me këtë vendim, obligohen të gjitha IAL-të në Republikën e Kosovës, që me rastin e deklarimit të stafit akademik në platformën e-akreditimi të AKA-së, ta bëjnë ngarkimin e disertacionit të doktoratës dhe të publikimeve në revistat e indeksuara, në platformat e përcaktuara me Manualin e AKA-së për akreditim. Ky vendim obligon zbatimin e përpiktë të



standardeve evropiane të cilësish të cilat decidivisht thonë se ‘institucionet (e arsimit të lartë) kanë politika dhe procese që garantojnë dhe përmirësojnë cilësinë e aktiviteteve të tyre, si

hulumtimi dhe qeverisja’. Si ministre e Arsimit pres që rastet e plagjiaturës të raportuara deri tash të trajtohen me seriozitet nga organet e Universitetit të Prishtinës. Ngritja e cilësish në

arsimin e lartë është një nga prioritetet kryesore të qeverisë dhe MASHTI-it për çka jemi duke u angazhuar shumë që nga fillimi i mandatit”, ka thënë Nagavci.

## Nis edicioni i 40 i seminarit të Gjuhës Shqipe

PRISHTINË, 15 GUSHT - Për dy javë mbi 100 mysafirë nga e gjithë bota do të marrin pjesë në edicionin e Seminarit të Gjuhës Shqipe. Këtë vit po mbahet edicioni i dyzetë, në të cilin po marrin pjesë albanologë të huajë dhe vendorë. Të hënën kanë nisur punimet e këtij edicioni jubilar, i cili do të zgjasë deri më 26 gusht. Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare është thënë se është ngjarja më e rëndësishme në fushën e albanologjisë.

Në hapje të seminarit fjalën e kryeministrit e ka lexuar ministria e Arsimit, Arbërie Nagavci, e cila ka folur për rëndësinë e gjuhës dhe kulturës shqiptare. “Gjuha dhe fjalët një nga një na mbajnë gjithmonë para një përgjegjësie të lartë, madje ndoshta jo vetëm të përgjegjësisë, por edhe të borxhit. Gjuha na ka dhënë aq shumë secilit prej nesh, por kjo dhënie në fund dhuratë prej gjuhës dhe prej hartuesve të saj duhet të



kthehet në marrëdhënie, pra atë që e kemi marrë duhet edhe ta japim. Raporti mes gjuhës e kombit nuk është veçse historik. Këto janë dy vetëdije që po e ndihmojnë dijen dhe kureshtjen universale. Njëpërmjet gjuhës jo vetëm është mësuar dashuria për kombin, por edhe për jetën, për gjuhën dhe njerëzoren”, ka thënë Nagavci.

Më tutje, ajo ka thënë se roli i seminarit ka vlerë të madhe. “Edicioni i dyzetë i seminarit për aq sa jam njoftuar do të ketë numrin më të madh të seminaristëve e pjesëmarrësve ndonjëherë, rreth 150 sosh. Duke ju përgëzuar për këtë vit jubilar uroj për ligjërata, sesione e kurse sa më të frytshme të shtjellimit të problematikave gjuhësore dhe

të mësimin të shqipes”, ka thënë Nagavci, duke lexuar fjalimin e kryeministrit Kurti. Ndërsa ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Nicholas Abbott, gjatë fjalimit të tij në gjuhën shqipe ka treguar për periudhën e tij nëntëmujore të mësimin të kësaj gjuhe. Në shënimin e edicionit të dyzetë të këtij seminar, rektori i Universitetit të Prishtinës,

Naser Sahiti, ka folur për vështirësitë e organizimit të këtij seminar në fillimin e tij. Ndërsa drejtori i seminarit të Gjuhës Shqipe, Shkumbin Munishi, ka thënë se edicioni i sivjetmë është duke u mbajtur në përputhje me traditën e krijuar përgjatë pesë dekadave. Seminari është organizim i përbashkët me Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë dhe Fakultetin të Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës.

Zëvendësrektori Bernard Dosti në hapjen e këtij seminar ka thënë se seminari i Prishtinës ka një traditë të suksesshme. Kurse dekanja e Fakultetit të Filologjisë në Prishtinë, Lindita Rugova, ka thënë se prania e seminaristëve po i kthen Prishtinën dhe UP-në në qendër të diskutimeve dhe të aktivitetit akademik. Ky seminar, i cili është themeluar në vitin 1974, organizohet për studentët dhe studiuesit e gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare, por edhe për albanologjinë në përgjithësi.

## Shpallen zgjedhjet e brendshme për pozicionet drejtuese në LV

PRISHTINË, 15 GUSHT (ER) - Lëvizja Vetëvendosje ka shpallur zgjedhjet e brendshme për kandidatët për pozicionet drejtuese. “Pas përfundimit të procesit zgjedhor në nivelin e parë organizativ, në pika, ku janë zgjedhur strukturat drejtuese të shtrira në lagje dhe fshatra, në kuadër të zgjedhjeve të brendshme dhe në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Zgjedhjeve të Brendshme, Lëvizja Vetëvendosje nga sot shpall zgjedhjet e brendshme për nivelin e dytë dhe të tretë

organizativ”, ka njoftuar Vetëvendosje.

Ky subjekt politik ka shtuar se niveli i tretë i zgjedhjeve është për kryetar, kryetare të gruas dhe kryetar të rinisë së LV-së. Ndërsa niveli i dytë ka të bëjë me zgjedhjen e kryetarit të qendrës, kryetares të GLV në qendër dhe kryetarit të RLV në qendër.

“Komisioni Zgjedhor Ad-hoc i Qendrës (KZAQ) njofton të gjithë aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje, Qendra... të cilët janë të interesuar për të kandiduar për pozicionet e

lartcekura, që ta paraqesin deklaratën e kandidaturës nga sot, 15 gusht, deri më 23 gusht 2022. Kandidatët e interesuar për të kandiduar, deklaratën e kandidaturës për të gjitha pozitat dhe nivelet mund ta marrin në zyrën e qendrës dhe të njëjtën ta dorëzojnë te Komisioni Zgjedhor Ad-hoc i Qendrës (KZAQ), ashtu siç është e paraparë me Statutin dhe Rregulloren e Zgjedhjeve të Brendshme të Lëvizjes Vetëvendosje”, ka njoftuar Vetëvendosje.





## Molliqaj paralajmëron protesta, shkak shkurtime e energjisë elektrike

PRISHTINË, 15 GUSHT (ER) - Lideri i Partisë Socialdemokrate (PSD), Dardan Molliqaj, ka reaguar pas rikthimit të shkurtimeve të energjisë elektrike. Ai ka paralajmëruar protesta në ditët në vijim, derisa ka theksuar se Kosovës i janë kthyer shkurtime pas 15 vjetësh. "Terri sot nuk është sikur ai i viteve të pas luftës. Na vjen me shije të propagandës: terri është i barabartë për të gjithë. Kosovës iu kthyen reduktimet pas afro 15 vjetësh. Reduktime verës. Nëse dikush ju tregon se qeveria s'ka faj, meqë kriza e çmimeve është globale, mos e kundërshtoni, vazhdojeni arsyetimin. Jo vetëm që kriza është globale dhe e shkaktuar nga lufta e Ukrainës. Vetë lufta në Ukrainë është shkaktuar për t'i ngritur çmimet, ashtu që pas ngritjes së çmimeve qeveria Kurti të ngulfatet nga brenda dhe të rrëzohet", ka shkruar Molliqaj në "Facebook".

Ai ka pyetur se kush po përballet me shkurtime të energjisë meqë kriza qenka globale. "Si bëhet që Shqipëria e ka shpenzimin më të madh verës, por atje s'ka reduktime. Pse nuk ka reduktime në Maqedoni, në Mal të Zi ose në Serbi? Apo të gjithë janë pjesë e komplotit imperialist të bashkuar kundër Albinit?! Bukur fort, qenka gjendje e trashëguar nga qeverisjet e mëparshme. Ky argument rrinë veç nëse presupozojmë që njerëzit nuk kanë as memorie afatshkurtër. Reduktimet erdhën me këtë qeveri. Ndryshim, apo jo?! Qeverisja dorështrënguar nuk është as e majtë, as zhvillimore. Këta i ruajnë paratë për ditët e zeza kur vetë ndihen të rrezikuar. Dhe pas secilit problem presin, ka edhe më keq. Paradoksalisht, duke bërë kështu, po ia ofrojnë vetes ditët e vështira. Inflacioni në Kosovë është sikur në gjendje lufte. Qeveria rrinë e struktur.



Energjia është shtrenjtuar. Tash edhe reduktime. Shpejt pritet ngritja tjetër e energjisë. Çmimet e mallrave pastaj.

Nëse asgjë nuk bie nga gjithë këto ngritje, kjo mungesë qeverinë e ka adresë. Diçka duhet të bie këtu, borxh nuk iu kemi.

Udhëzimet për përdorim të qebeve, protestën do ta kenë përgjigje", ka shkruar Molliqaj.

## Osmani për bartjen e shamisë në shkolla: Kush pretendon që i shkelen të drejtat t'i drejtohet Kushtetueses

PRISHTINË, 15 GUSHT (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka dhënë qëndrimin e saj lidhur me atë se a duhet vajzat nën moshën 16-vjeçare të mbajnë shaminë në institucione shkollore. Sipas saj, Kushtetuta e Kosovës e ka përcaktuar një parim themelor, që është fundamental, mbi të cilin edhe është ndërtuar sistemi juridiko-kushtetues dhe ai është parimi i laicitetit. Sa i përket propozimit që mosha të zbresë në 16 vjeç, Osmani ka theksuar se "në qoftë se kjo çështje lidhet me të drejtën e votës, atëherë do të kërkojë ndryshim të Kushtetutës sepse, siç e dini, ky prag është përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës". "Në radhë të parë më lejoni të potencoj që Kushtetuta e Republikës së Kosovës duhet të jetë, vazhdon të jetë orientim



parësor i institucioneve të Republikës së Kosovës për çdo çështje që ka të bëjë me liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Kjo Kushtetutë ka përcaktuar një parim themelor që është parim fundamental mbi të cilin edhe është ndërtuar sistemi ynë juridiko-kushtetues dhe ai është parimi i laicitetit.

Prandaj është tejet me rëndësi që në institucionet e Republikës së Kosovës të respektohet ky parim. Çështja e dytë që e ka përcaktuar qartë kjo Kushtetutë është detyrimi i të gjitha institucioneve publike të Republikës së Kosovës që t'i respektojnë vendimet e Gjykatës Evropiane për të

Drejtat e Njeriut, si standarde nëpërmjet të cilave zgjidhet çdo çështje që ka të bëjë me liritë dhe të drejtat e njeriut. Kurse çështja e tretë që dua ta potencoj është fakti që, për dallim nga shumë Kushtetuta anekënd botës që nuk ia lejojnë individit të drejtën që ta dërgojë një çështje të lirive dhe të drejtave të njeriut në Gjykatën Kushtetuese, te ne ekziston kjo mundësi", ka thënë Osmani, duke shtuar se kushdo që mendon se janë duke iu cenuar të drejtat mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. "Prandaj në qoftë se dikush mendon se po i cenohet ndonjë e drejtë, ekzistojnë rrugët ligjore, administrative e kushtetuese që ta adresojnë këtë çështje në të gjitha këto instanca deri te Gjykata Kushtetuese. Si presidente e vendit do të vazhdoj të kërkoj që të

respektohen parimet mbi të cilat është ndërtuar jo vetëm Kushtetuta jonë, por edhe shoqëria jonë si shoqëri progresiste, si shoqëri që i shikon parimet dhe vlerat euroatlantike si fundamentale. Sa i përket propozimit që mosha të zbresë te 16 vjet, në qoftë se kjo çështje lidhet me të drejtën e votës, atëherë do të kërkojë ndryshim të Kushtetutës sepse, siç e dini, ky prag është përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Por çdo ndryshim legjislativ kushtetues përfundimisht do të jetë vullnet i deputetëve të Republikës së Kosovës dhe unë asnjëherë deri më tani nuk e kam imponuar vullnetin tim mbi deputetët por, siç e thashë, është shumë me rëndësi që ky bazament kushtetues i Republikës sonë të respektohet", ka thënë Osmani.

## 25 kallëzime të rreme në polici, identifikohet 14-vjeçari nga Rahoveci

RAHOVEC, 15 GUSHT (ER) - Policia e Kosovës ka bërë me dije se prej 8 janarit 2022 deri më 14 gusht 2022 përmes aplikacionit "Lajmëro Policinë" pranë Stacionit Policor në Rahovec janë paraqitur 25 lajmërim të rreme për aktivitete të ndryshme kundërligjore në një kafeteri në fshatin Hoçë e Vogël. Sipas njoftimit të policisë, është thënë se sektori i hetimeve në Stacionin Policor

në Rahovec, në bashkëpunim me prokurorin e shtetit, për një kohë ka zhvilluar hetime për zbulimin e kryesit të kësaj veprë, duke përdorur teknika të ndryshme të hetimit dhe duke aplikuar masa të fshehta. Më tutje, është bërë me dije se personi i dyshuar për këto kallëzime të rreme është një i mitur, 14-vjeçar. "Me datë 15 gusht 2022 është arritur të identifikohet dhe arrestohet një person i dyshuar (mashkull/shqiptar/kosovar, i

moshës 14 vjeçare), i cili në prani të avokatit mbrojtës dhe punëtorit të Qendrës për Punë Sociale është intervistuar dhe në tërësi ka pranuar se ka bërë lajmërim të rreme. Si provë materiale është sekuestruar një telefon mobil i cili është përdorur për paraqitjen e këtyre veprave. I dyshuari, pas intervistimit, është liruar, ndërsa ndaj tij është iniciuar rast 'Lajmërim apo kallëzim i rremë", ka njoftuar policia.





## Rukiqi: Refuzuam projekte strategjike për energji me argumente të kota

**PRISHTINË, 15 GUSHT (ER)** - Berat Rukiqi, ish-kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës dhe profesor në Universitetin e Prishtinës, ka thënë se sikur qeveria aktuale e Kosovës të mos refuzonte disa projekte të ofruara për energjinë, situata në këtë sektor do të ishte më e mirë dhe "s'do të bëheshim vendi i vetëm në Evropë që

fillon reduktimet" ende pa filluar dimri. "Donim të ishim kampionë në luftimin e ngrohjes globale, duke refuzuar dhe luftuar çdo projekt të energjisë bazuar në atë çka na e kemi resurs të vetëm me bollëk: thëngjillin. Donim të ishim refuzues të projekteve strategjike, veçanërisht të atyre me gaz,

duke kontestuar çdo fizibilitet, me argumente të kota për kostot, çmimet, ambientin dhe pa asnjë analizë. Në fakt, kjo bëhej për ta ruajtur pavarësinë nga 'imperializmi' që synonte të shtrihej përmes gazit (mendësia e të majtës anti-imperialiste). Në kohën e fillimit të krizës energjetike, në vend të gjetjes së zgjidhjes për

krizën që dihej që do të zgjaste, synimi ishte tjetër: gjetja e arsyeve dhe zgjidhjeve për nacionalizim të pronave private. Rezultati: vendi i vetëm në Evropë me reduktime të energjisë elektrike, ende pa filluar koha e konsumit 'peak' të energjisë elektrike. Edhe pak investime të planifikuara do të stagnojnë.



Drejt stagnimit, të sigurt dhe krenarë me rritjen ekonomike të vitit 2021", ka thënë Rukiqi.

## Opozita e akuzon qeverinë për keqmenaxhim të energjisë

Pas shumë vitesh, në Kosovë të hënën janë rikthyer shkurtimet e energjisë elektrike. KEDS-i ka njoftuar se shkurtimet do të jenë 6 orë me energji dhe 2 pa të. Sipas KEDS-it, gjatë shqyrtimit të jashtëzakonshëm tarifor, rregullatori kishte marrë parasysh subvencionin e qeverisë prej 100 milionë eurosh, por asnjë cent nga ajo shumë nuk është shpërndarë te furnizuesi. Por, Ministria e Ekonomisë ka bërë me dije se të hënën gjatë ditës ka arritur t'i shmangë shkurtimet falë bashkëpunimit me Shqipërinë. Në lidhje me situatën energjetike kanë reaguar përfaqësuesit e partive opozitare, duke e akuzuar qeverinë për keqmenaxhimin e këtij sektori



rymës. "Humbjet komerciale (të shkaktuara nga vjedhjet) dhe teknike të kompanisë KEDS janë 19 për qind. Këto humbje ende mbulohen nga të gjithë, pra prodhimi ose importi, jo nga KEDS-i", ka njoftuar kjo ministri. Ministria e Ekonomisë ka thënë se qeveria do të marrë masa për çështjen e ngrohjes gjatë muajve në vijim "për t'i ndihmuar qytetarët". "Tutje, qeveria do të marrë masa për çështjen e ngrohjes gjatë muajve në vijim për t'i ndihmuar qytetarët. Prandaj, të gjithë qytetarët dhe sipërmarrësit, të cilët janë duke planifikuar të bëjnë investime në sistemet e tyre të ngrohjes, ftohen e rikujtohen që t'i ndërojnë ato nga energjia elektrike në forma të tjera të burimit të energjisë", ka njoftuar Ministria e Ekonomisë. Të hënën pasdite kjo ministri përmes një njoftimi ka bërë me dije se falë bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Shqipërisë do të kthehet furnizimi i rregullt me energji elektrike.

### Opozita akuzon qeverinë për keqmenaxhim të sektorit të energjisë

Në lidhje me situatën energjetike në Kosovë kanë reaguar përfaqësuesit e partive opozitare. Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bernard Nikaj, në një konferencë për medie ka kërkuar përgjegjësi dhe llogaridhënie nga qeveria Kurti për paaftësi të menaxhimit të krizës energjetike, e cila ka ndikuar që nga sot qytetarët e Kosovës të përballen

me shkurtime të energjisë. Nikaj ka thënë se kjo situatë 6 orë me rrymë dhe 2 pa rrymë në mes të gushtit është dështim kapital i logjikës rrugë pakrye të Albin Kurtit, që ka imponuar edhe çmim më të lartë për rrymë dhe shkurtime. "Fatkeqësisht, në një vend me qeverisje të paaftë, depresive e të papërgjegjshme, siç është qeveria e Albin Kurtit, kjo është asgjë më pak sesa manifestim i keqmenaxhimit, i cili, për faktin që po ndodh tash kur nuk është dashur as të paramendohej, rrezikon të bëhet normë, atëherë kur edhe mund të presim përkeqësim të situatës me furnizim të energjisë elektrike gjatë dimrit", ka thënë ai. Sipas Nikajt, terri me të cilin po shërbehen qytetarët e Kosovës sot, është produkt i një dështimi sistematik dhe kardinal disamujor të menaxhimit të KEK-ut nga ana e qeverisë, e cila po heshtë karshi kësaj situatë përkundër që secili qytetar i Kosovës po cenohet nga përditshmëria e tij për shkak të shkurtimeve.

Më tutje, Nikaj në emër të PDK-së e ka konsideruar të pafalshme që qytetarët e Kosovës të mësojnë në mbrëmje se të nesërmen nuk do të ketë energji elektrike dhe që në kushtet optimale të prodhimit të energjisë elektrike të ketë shkurtime. Ndërsa deputeti i LDK-së, Besian Mustafa, ka thënë se Kosovën është duke e pritur një dimër mesjetar për shkak të keqmenaxhimit të sektorit të energjisë nga ana e qeverisë Kurti. "Dimër mesjetar po na vjen. Qeveria rrudhë krahët! As frigoriferi i famshëm s'do t'ju ketë

rymë. Reduktimet e rrymës 6-2 në mes të gushtit. E në dimër? Dhe peleti mbi 400 euro. Dhe drunjtë drejt 100 euro. E kur s'punon KEK-u, s'do të ketë as ngrohje qendrore. Çmimi i rrymës pritet të dyfishohet. Çmimet e produkteve esenciale, si ushqimi, deri sot janë rritur për 14.2 për qind. E deri në dhjetor? Këtë dimër familjet kosovare do të duhet të zgjedhin bukë të shtrenjtë apo dru/pelet/rymë të shtrenjtë për ngrohje... Nëse do të mund të gjejnë dru/pelet/rymë për të blerë. Kundërshtuan, protestuan, sulmuan deri në dështim zyrtar termocentralin me thëngjill 'Kosova C' dhe termocentralin me gaz", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook". Më tutje, Mustafa ka thënë se me këtë paaftësi qeverisëse, sipas tij, nuk përjashtohet situata ku çerdhet, shkollat, qendrimit ditore nuk do të kenë me çka t'i ngrohin klasat e tyre. "Do t'i detyrojnë prindërit t'i kthejnë fëmijët në shtëpi... ku as atje s'kanë ngrohje e as rrymë. Kush do t'i kryejë punët e këtyre prindërve në vendet e tyre të punës... ku s'ka as ngrohje e as rrymë?", ka shkruar Mustafa. Ndërsa deputeti i AAK-së, Pal Lekaj, eka quajtur të paaftë qeverinë Kurti për ta tejkaluar krizën energjetike në vend. Lekaj ka thënë se qeveria ka ndarë 40 milionë euro për t'i mbuluar shpenzimet e rrymës në veri të vendit, ndërsa qytetarëve të pjesë tjetër të Kosovës u rritet çmimi i faturave të energjisë. "Ne me kohë patëm paralajmëruar qeverinë për krizën që na pret me energji elektrike. Gabim fatal i kësaj qeverie ishte anulimi i ndërtimit të termocentralit Kosova C, me çka do të siguronim stabilitet energjik. Po shihet që qeveria është e paaftë për të ofruar një zgjidhje që sjell stabilitet energjetik dhe qytetarëve u mundëson rrymë pa reduktime dhe pa rritje të çmimit të faturave. Mos ta harrojmë pagesën prej 40 milionë eurosh për veri përderisa qytetarëve të pjesës tjetër të Republikës së Kosovës i rritet çmimi i faturave të energjisë", ka thënë Lekaj për "Epokën e re".

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 15 GUSHT** - Për shkak të mossubvencionimit nga ana e Qeverisë së Kosovës, KEDS-i ka njoftuar se që nga e hëna do t'i fillojnë shkurtimet e energjisë elektrike. KEDS-i ka njoftuar se ka pranuar urdhëresë nga Qendra Nacionale Dispecerike e Kosovës, pjesë e KOSTT-it, që të fillojë kufizimet e energjisë elektrike nga ora 8:00 e ditës së hënës. Këto kufizime do të jenë deri në 2 orë për të gjithë konsumatorët, pra konsumatorët gjatë ditës së hënës do të kenë nga 6 orë energji elektrike dhe 2 orë kufizime. Prej ditës së hënës vendi do të furnizohet vetëm nga prodhimi vendor. "KEDS dhe KESCO nuk kanë mundësi financiare të nominojnë energji jashtë asaj që prodhohet nga gjeneratorët vendorë. Deri te kjo situatë ka ardhur për shkak të çmimeve enorme që ekzistojnë në tregjet ndërkombëtare dhe mosmbulimit të kostos së sistemit. Kjo ka sjellë situatë të rëndë financiare edhe për KOSTT-in, të cilën ENTSO nuk e lejon më të bëjë devijime. Kjo bën që secila kërkesë mbi prodhimin vendor të kufizohet në pamundësi të mbulimit nga importi", ka njoftuar KEDS-i.

Siç është theksuar në njoftimin e KEDS-it, energjia elektrike e blerë deri tani ka shkaktuar humbje

enorme si për KEDS-in dhe për KESCO-n. Sipas KEDS-it, gjatë shqyrtimit të jashtëzakonshëm tarifor rregullatori kishte marrë parasysh subvencionin e qeverisë prej 100 milionë eurosh, por asnjë cent nga ajo shumë nuk është shpërndarë te furnizuesi.

"Kjo e ka rënduar gjendjen edhe më tepër. Sot, disa muaj pas, të gjitha mundësitë financiare janë shteruar. Të dy kompanitë vitin e fundit e kanë mbyllur vitin me humbje të mëdha financiare, njëra 27.8 milionë euro, tjetra 18.5 milionë euro, në një total që shkon në mbi 46 milionë euro humbje. Dy kompanitë, pra KEDS-i dhe KESCO, nuk mund ta bartin më të vetme barrën e krizës botërore energjetike dhe pasojat e saj në Kosovë. Kërkohej me urgjencë edhe veprimi i aktorëve të tjerë në mënyrë që së bashku ta përballojmë këtë krizë", ka njoftuar KEDS-i.


Edhe Ministria e Ekonomisë, përmes një komunikate për medie, ka folur për gjendjen e furnizimit me energji elektrike dhe masat e emergjencës. Kjo ministri ka njoftuar se prodhimi ditore i KEK-ut është rreth 507 MWh, ndërsa kërkesa për konsum është deri në 750 MWh. Kjo ministri ka bërë me dije se çmimi në bursën hungareze (HUPX) është rreth 430 euro për MWh.

Ndër të tjera, Ministria e Ekonomisë e ka akuzuar KEDS-in se është duke toleruar vjedhjen e

thënë se, bazuar në përgjegjësi të Departamentit për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve në ATK, janë përzgjedhur 18 subjekte me obligime të papaguara në vlerë

prej 1.8 milion eurosh. "Pjesa tjetër e borxheve të këtyre bizneseve pritet të inkasohet bazuar në marrëveshjet e reja të lidhura për pagesën e obligimeve tatimore me këste, si

dhe marrëveshjeve të riprogramuara për bizneset të cilat nuk u janë përmbajtur marrëveshjeve paraprake. Menaxhmenti i ATK-së vazhdon ta ketë në prioritet zvogëlimin e



stokut të borxheve si dhe trajtimin në kohë të borxheve të reja", ka njoftuar ATK-ja.

## ATK-ja inkason 416 mijë e 250 euro borxhe nga bizneset

**PRISHTINË, 15 GUSHT (ER)** - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se ka inkasuar borxhe në vlerë 416 mijë e 250 euro nga 18 subjekte biznesore. Në njoftimin për medie është



# Pse “Vargjet Satanike” të Salman Rushdie mbetet kaq i debatuar, edhe pas disa dekadash



Një nga librat më të diskutueshëm në historinë e kohëve të fundit letrare, “Vargjet Satanike” të Salman Rushdie, u botua mbi tre dekada më parë dhe pothuajse menjëherë shkaktoi demonstrata e zemëratë në të gjithë botën, disa prej tyre të dhunshme. Një vit më vonë, në vitin 1989, udhëheqësi suprem i Iranit, Ayatollah Khomeini, nxori një fetva, ose vendim fetar, duke urdhëruar muslimanët të vrisnin autorin.

I lindur në Indi në një familje myslimane, por në atë kohë shtetas britanik që jetonte në Mbretërinë e Bashkuar, Rushdie u detyrua të fshihej për pjesën më të madhe të një dekade.

Çfarë kishte – dhe ende ka – prapa gjithë këtij zemërimi?

## Polemika

Libri, “Vargjet Satanike”, shkon në zemër të besimeve

fetare myslimane kur Rushdie, në sekuenca ëndrrash, sfidon dhe ndonjëherë duket se tallet me disa nga parimet e tyre më të ndjeshme.

Muslimanët besojnë se Profeti Muhamed u vizitua nga engjëlli Gibreel – Gabriel në anglisht – i cili, gjatë një periudhe 22 vjeçare, i recitoi fjalët e Zotit atij. Nga ana tjetër, Muhamedi ua përsëriti fjalët pasuesve të tij. Këto fjalë përfundimisht u shkruan dhe u bënë vargje dhe kapituj të Kuranit.

Romani i Rushdie përfshin këto besime thelbësore. Një nga personazhet kryesore, Gibreel Farishta, ka një sërë ëndrrash në të cilat bëhet adashi i tij, engjëlli Gibreel. Në këto ëndrra, ai ndeshet me një personazh tjetër qendror në mënyra që i bëjnë jehonë rrëfimit tradicional të Islamit për takimet e engjëllit me Muhamedin.

Rushdie zgjedh një emër

provokues për Muhamedin. Në versionin e romanit, Profeti quhet Mahound – një emër alternativ për Muhamedin i përdorur ndonjëherë gjatë Mesjetës nga të krishterët që e konsideronin atë djall.

Për më tepër, Mahoundi i Rushdies vendos fjalët e tij në gojën e engjëllit Gibreel dhe u jep ndjekësve të tij dekrete që u shkojnë për shtat vetëm qëllimeve të tij egoiste. Edhe pse, në libër, shkruesi imagjinar i Mahound, Salman Persiani, refuzon vërtetësinë e recitimeve të Zotit të tij, ai i regjistron ato sikur të ishin të Zotit.

Në librin e Rushdie, Salman, për shembull, ia atribuon disa pasazhe aktuale në Kuran që i vendosin burrat “mbi gratë” dhe u japin burrave të drejtën të godasin gratë.

Nëpërmjet Mahound, Rushdie duket se hedh dyshime mbi natyrën hyjnore të Kuranit.

## Sfidim i teksteve fetare?

Për shumë myslimanë, Rushdie, në ritregimin e tij imagjinar të lindjes së ngjarjeve kryesore të Islamit, nënkupton se, në vend të Zotit, Profeti Muhamed është vetë burimi i të vërtetave të shpallura.

Në mbrojtje të Rushdie, disa studiues kanë argumentuar se “tallja e tij e pandershme” synon të eksplorojë nëse është e mundur të ndahet fakti nga trillimi. Eksperti i letërsisë Greg Rubinson thekson se Gibreel nuk është në gjendje të vendosë se çfarë është e vërtetë dhe çfarë është një ëndërr.

Që nga botimi i “Vargjeve Satanike”, Rushdie ka argumentuar se tekstet fetare duhet të jenë të hapura për t’u sfiduar. “Pse nuk mund të debatojmë për Islamit?” tha Rushdie në një intervistë të vitit 2015.

“Është e mundur të respektosh individët, t’i mbrosh nga intoleranca, ndërkohë që të jesh skeptik për idetë e tyre, madje edhe t’i kritikosh me forcë”.

Megjithatë, kjo pikëpamje bie ndesh me mendimin e atyre për të cilët Kurani është fjala e Zotit.

Pas vdekjes së Khomeinit, qeveria e Iranit njoftoi në vitin 1998 se nuk do ta zbatonte fetvanën e tij ose nuk do të inkurajonte të tjerët ta bënin këtë. Rushdie tani jeton në Shtetet e Bashkuara dhe bën paraqitje të rregullta publike.

Megjithatë, 30 vjet më vonë, kërcënimet ndaj jetës së tij vazhdojnë. Edhe pse protestat masive kanë pushuar, temat dhe pyetjet e ngritura në romanin e tij mbeten shumë të debatuar. /

The Conversation – Bota.al



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Shkëlqimi i Malvinës në vitin 2022



**PRISHTINË, 15 GUSHT** - Basketbollistja e talentuar Malvina Haziri së fundi është transferuar në Turqi në ekipin e Cukurova Basketball. Natyrisht se viti 2022 do të mbetet në mendjen e Malvinës, e për këtë ka folur vetë Malvina për faqen zyrtare të FBK-së. "Viti 2022 ka qenë viti më dinamik që nga fillimet e mia në basketboll, padyshim edhe më i suksesshmi. Unë qysh nga fillimi kam qenë pjesë e klubit Vushtrria Basket dhe me ndihmën e dy trajnerëve të Vushtrria Basket, Arianit Morina dhe Arsim Berisha, të cilët i falënderoj shumë, kam mësuar shumë dhe jam forcuar shumë. Çdo sukses timin ua dedikoj atyre, sepse me ta jam rritur dhe zhvilluar. Pastaj, gjatë 2022-s kam qenë pjesëmarrëse edhe në projektin FIBA YDE, i cili me ndihmën e trajnerëve Kimete Haliti dhe Valbona Bytyqi më ka ndihmuar shumë të mësoj gjëra të reja dhe të forcohem ende më shumë. Edhe në

muajin prill kam marrë pjesë në kampin elitare të JR NBA, që ka qenë përvojë fantastike. Të gjitha këto e bëjnë vitin 2022 një vit shumë të veçantë", ka thënë Malvina. Basketbollistja e Kosovës ka folur për transferimin e saj në Turqi. "Në Turqi po ndihem mirë. Natyrisht po më mungon familja dhe vendi im, por kam filluar të mësohem. Kam filluar të krijoj shoqëri, i gjithë stafi i klubit është shumë i mirë, kam përkujdesje maksimale, kështu që çdo ditë është edhe më e mirë. Natyrisht që do të më ndihmoj shumë. Këtu jam e angazhuar çdo ditë në stërvitje nga të cilat po mësoj shumë dhe patjetër e shoh si një mundësi shumë të mirë për ta forcuar veten time dhe të nxjerr më të mirën nga vetja ime", ka pohuar ajo. Malvina ka folur edhe për pritshmëritë rreth të ardhmes: "Fillimisht do të punoj fort e do të mundohem maksimalisht të jem e mirë këtu ku jam për momentin dhe pastaj të luaj në

nivele edhe më të larta. Natyrisht që diku në nivel evropian, pse jo edhe botëror". Haziri së fundi ka qenë pjesë e JR NBA e cila është mbajtur në Itali. "Jr. NBA ka qenë një përvojë fantastike nga e cila kam mësuar shumë. I jam shumë falënderuese Federatës së Basketbollit të Kosovës që më ka zgjedhur të jem pjesëmarrëse. Pastaj, edhe përzgjedhja në top 10 do mbetet një nga ngjarjet më të rëndësishme në karrierën time. Kjo do të më mundësoj ta vazhdoj kampin trajnues edhe në Abu Dhabi gjatë muajit tetor dhe të shikoj një nga ndeshjet më të mëdha të NBA", ka shtuar ajo. Për fund Malvina ka folur edhe rreth përfaqësimit të Kosovës. "Jam më shumë se krenare të luaj për vendin tim. Është ndjenjë e papërshkrueshme dhe pa dyshim do të ishte kënaqësi që një ditë të jem pjesë edhe e Kosovës A", është shprehur ajo për faqen zyrtare të FBK-së.

## SHKURT

### FFK-ja nënshkruan memorandum të bashkëpunimit me komunën e Istogut

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka qëndruar të hënën për vizitë në komunën e Istogut, ku është pritur nga kryetari Ilir Ferati. Me këtë rast është bërë nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet FFK-së, komunës dhe KF Istogu. Pjesë e këtij memorandumit do të jetë edhe ndërtimi i fushës stërvitore, që do t'u shërbejë të gjitha klubeve dhe shkollave të futbollit të kësaj komune, por që do të jetë nën menaxhimin e KF Istogu. Kryetari i FFK-së shprehu mirënjohjen e tij për kryetarin Ferati për bashkëpunim të ngushtë dhe për gatishmërinë për ta ndihmuar KF Istogu, por edhe për zhvillimin e futbollit në përgjithësi. Në anën tjetër, edhe kryetari i komunës së Istogut e falënderoi kryetarin Ademi dhe FFK-në që po u qëndrojnë afër klubeve dhe po kujdesen për krijimin e kushteve sa më të mira për zhvillimin e aktiviteteve të tyre.

### Hapet periudha e parë e afatit kalimtar në volejbollin e Kosovës

Të hënën është hapur zyrtarisht periudha e parë e afatit kalimtar për lojtarë vendorë, e cila do të jetë e hapur deri më 31 gusht në orën 18:00. Kjo është mundësia e parë për klubet dhe lojtarët që t'i bëjnë lëvizjet përforcuese dhe ndryshuese para afatit kalimtar të janarit. Qysh në ditën e parë janë paraqitur kërkesa për kalime dhe pritet të jetë një afat kalimtar aktiv dhe interesant. Klubet dhe volejbollistët janë njoftuar për rregulloren e lëvizjeve sipas normave të përcaktuara nga Federata e Volejbollit të Kosovës.

### Trajneri i Arsenalit u jep detyra të reja Xhakës dhe Jesusit

Granit Xhakës raportohet se i është dhënë një rol udhëheqës në skuadrën e Mikel Artetas, ndërsa Arsenali kërkon ta vazhdojë fillimin e pamposhtur në sezonin e ri të Ligës Premierë. Sipas një raporti nga "The Athletic", mesfushori shqiptar dhe nënshkrimi i ri Gabriel Jesus janë emëruar nga trajneri spanjoll për të shërbyer në pozitë drejtuese të skuadrës. Xhaka dhe braziliani do të jenë pjesë e grupit kryesor drejtues së bashku me kapitenin Martin Odegaard dhe do të jenë zëvendësues të kapitenit të parë.

### Aliaj: FShF-ja e injoroi sulmuesin që i tha po Kosovës

Adrian Aliaj ka thënë se shqiptari që po shkëlqen në kampionatin kroat është sulmuesi 23-vjeçar Emir Sahiti, i cili luan te Hajduku i Splitit. Ai bëri me dije se Shqipëria e injoroi Sahitin dhe tash ai e ka zgjedhur Kosovën. "Për Sahitin kemi interes nga klubi i madh gjerman Hamburg. Nuk e di nëse do të realizohet apo jo, por do të presim deri në fund të merkatos. Shqipëria aty e kishte lojtarin, por e humbi. Për vite të tëra nuk u interesuan të vinin ta shikonin një herë në Kroaci, por është çështje menaxhimi dhe profesionalizmi. Ai po shkëlqen te Hajduku, duke qenë ndër më të mirët. Pasi priti për shumë kohë dhe nga Shqipëria nuk u kujtuan kurrë, vendosi të luajë për Kosovën. Është e çuditshme që si ka mundësi lojtarin më të mirë të klubit të madh kroat nuk vijnë ta shikojnë nga FShF-ja, qoftë edhe një herë, edhe pse ka qenë me Shqipërinë U-21", ka thënë Aliaj për "Panorama Sport".

## Ballkani konfirmon largimin e katër futbollistëve

**SUHAREKË, 15 GUSHT** - Kampioni në fuqi i Kosovës në futboll, FC Ballkani, ka konfirmuar se ka shkëputur kontratat me marrëveshje të dyanshme me katër futbollistë. Bëhet fjalë për

Kushtrim Gashin, Theophilus Solomon, Dilivio Hoffman dhe Arens Mateli. Gashi dhe Mateli kanë nënshkruar me Prishtinën, ndërsa Solomon me Gjilanin. "Ju njoftojmë se Kushtrim Gashi, Theophilus

Solomon, Dilivio Hoffman dhe Arens Mateli nuk janë më pjesë e FC Ballkanit. Me lojtarët e lartcekur kemi ndërprerë kontratat me marrëveshje të dyanshme dhe me mirëkuptim. Ne si klub i

falënderojmë për kontributin e dhënë për mbrojtjen e ngjyrave të klubit tonë. Me këtë rast u urojmë shëndet dhe suksese të mëtutjeshme në futboll", thuhet në njoftimin e skuadrës së Ballkanit.





## Chelsea e sheh Brojën si të ardhmen e sulmit

LONDËR, 15 GUSHT - Chelsea vijon fushatën e spastrimeve, mbi të gjitha në fazën sulmuese, duke ndërtuar një ekip thuasj nga e para. Nga Londra u larguan Lukaku dhe Timo Werner, duke krijuar më shumë hapësira për Armando Brojën. Në dy

sfidat e para në Premierë Ligë, trajneri Thomas Tuchel i ka rezervuar pak minuta yllit kuqezi, por ky fakt nuk ndryshon asnjë në lidhje me planet e klubit për sulmuesin 20-vjeçar. Sipas medieve angleze, klubi i Chelsea ka programuar një tjetër takim me përfaqësuesit e Brojës,

këtë herë për të negociuar për hollësitë e kontratës së re. Chelsea jo vetëm që nuk ka ndër mend të privohet nga shërbimet e Brojës, por është gati t'i ofrojë një kontratë të re. Aktualja i përfundon më 2026. Ideja e drejtuesve londinezë është ta blindojnë Brojën teksa e

konsiderojnë si e ardhmja e klubit. Në kontratën e re parashikohet edhe një rritje e ndjeshme e pagës. Me këtë lëvizje, Chelsea u dërgon një sinjal të qartë të gjithë pretendentëve që kërkojnë shërbimet e Brojës. Për momentin ylli kuqezi është thjesht i pashitshëm.



## Christian Mba, 'ylli i javës' në Superligë

MITROVICË, 15 GUSHT - Sulmuesi i Trepçës '89, Christian Mba, është shpallur futbollisti më i mirë i javës së parë në Superligën e Kosovës në futboll. Edhe këtë edicion FFK-ja do ta ndajë çdo javë këtë çmim, ndërsa vlerësimin do ta bëjë komisioni treanëtarësh nga Liga e Veteranëve të Futbollit të Kosovës. Këtë javë komisioni në përbërje: Muhamet Sylejmani nga KFV Mitrovica, Agim Xhakolli nga KFV Vushtrria dhe Selami Tuzi nga KFV Gjakova vendosen unanimitisht për futbollistin e Trepçës '89. Sulmuesi nigerian pati paraqitje të shkëlqyeshme në ndeshjen kundër Dritës në stadiumin "Riza Lushta" dhe kjo bëri që komisioni ta vlerësojë atë me çmimin "Ylli i javës". Mba realizoi dy supergola për "Minatorët", teksa gjatë tërë ndeshjes pati paraqitje shumë të mirë, duke qenë më i merituari që skuadra e tij rikthimin në elitë pas një viti ta nisë me arkëtimin e një




pike, ndonëse ishte në rrugë të mirë edhe për të fituar. E ky çmim për nigerianin Mba ka peshë. "Jam shumë i lumtur që jam shpallur 'Ylli i Javës' në xhiron e parë të Superligës. Kundër Dritës patëm një paraqitje shumë të mirë. Loja ishte dinamike dhe mjaft e mirë.

Ne u angazhuam shumë dhe pas epërsisë 2:0 prisnim fitore, por nuk ndodhi. Do të punojmë shumë në këtë edicion për ta pozicionuar Trepçën '89 sa më lart. Shpresoj të vazhdoj me lojërë të mira dhe të jap sa më shumë gola", ka thënë Mba.

## Tysoni këshillon Joshuan se si ta mposhtë Usykun

LONDËR, 15 GUSHT - Mike Tyson nuk i jep shumë mundësi Anthony Joshuas në revanshin e tij me Oleksandr Usyk këtë të shtunë. Luftëtari britanik do të ndeshet me ukrainasin për herë të dytë në përpjekje për t'i rifituar titujt e më të mirë të botës në peshat e rënda WBA, IBF dhe WBO, që i humbi një vit më parë. Boksieri ukrainas fitoi me atë rast me vendim unanimit të gjyqtarëve (117-112, 116-112 dhe 115-113). "Ai do ta ketë vërtet të vështirë ta mposhtë Usykun. Do të jetë e vështirë kjo, sepse ukrainasi është i shpejtë dhe e kaloi Joshuan me goditjen e tij. Joshua duhet të mësojë se si të merret me goditjen e tij. Kjo është e vetmja gjë që ai nuk mundi ta përballonte. Ishte e qartë, anglezi nuk mundi ta përballonte goditjen



dhe lëvizjet e kundërshtarit. Ai është një grushtues i fuqishëm, por nuk është aq i saktë. Duhet të jesh i saktë kundër një djaloshi të tillë, sepse ai lëviz shumë. Do të duhet

ta lodhësh, ndryshe nuk e mposht dot Usyk. Nuk mjafton thjesht ta godasë. Joshua duhet të rrisë ritmin, vetëm pak, jo shumë. Ai ka shumë potencial", ka thënë Tyson.

### SHKURT

#### Spaçi, pjesë e programit FECC

Trajneri i Kosovës U-16, Valentin Spaçi, së fundi ka qenë pjesë e Programit FECC (FIBA Europe Coaching Certificate), që është mbajtur në Izmir të Turqisë. Spaçi për shtatë ditë me radhë ka pasur mundësi të punojë me trajnerë të ndryshëm në aspekte të ndryshme. Mbrojtja, sulmi, depërtimi ishin disa nga temat kyçe që u zhvilluan në këtë punëtori. Programi është mbështetur nga Federata e Basketbollit të Kosovës, që ka përzgjedhur Spaçin për këtë program. Së fundi në programin FECC është certifikuar Gyltekin Selimi, ndërsa më herët edhe trajnerët si Dritëro Sefaja, Edon Godeni, Petrit Zeqiri dhe Ilir Selmani, gjithashtu që ishin nominuar nga FBK-ja.

#### Gundogan emërohet kapiten i ri i Cityt

Ilkay Gundogan është votuar nga shokët e skuadrës për të qenë kapiteni i ri i Manchester Cityt. Ndërkohë që zëvendësi i mesfushorit gjerman do të jetë Kevin de Bruyne. Skuadra e cila e zgjedh liderin e saj në mënyrë demokratike, pa ndërhyrjen e trajnerit, votoi liderët e rinj pas largimit të ish-kapitenin Fernandinho pas nëntë vjetësh në "Etihad" këtë verë dhe mbështetjen më të madhe e ka marrë ish-mesfushori i Borussia Dortmundit, i cili luan prej 2016-s me kampionët e Anglisë.

#### Barça refuzon ofertën e Chelseat për Aubameyangun

Chelsea është e vendosur për ta transferuar sulmuesin Pierre Emerick Aubameyang nga Barcelona. Edhe pse Xavi theksoi se Aubameyang është pjesë e projektit të klubit, Chelsea paraqiti një ofertë prej 14 milionë eurosh për sulmuesin gabonez. Klubi spanjoll e refuzoi dhe thuhet se ka kërkuar të paktën 20 milionë euro.

#### Cavani, dëshira e madhe e Nices

Klubi francez i Nices është duke menduar për një transferim të mundshëm të Edison Cavanit për ta përmirësuar repartin sulmues. Sipas "Sky Sport", tekniku i Nices ka pranuar se uruguaiiani është një lojtar i jashtëzakonshëm edhe pse ndodhet në këtë moshë. "Ai dhe Bamba Dieng janë lojtarë interesantë, shënojnë, por për momentin nuk mund të shtoj asgjë tjetër. Nuk jam unë ai që po punoj personalisht për këto negociata. Nuk është e lehtë t'i përfundosh ato", ka thënë trajneri Lucien Favre.

## Marquez: Po të mos operohesha, do të tërhiqesha nga sporti

Për të tretin vit me radhë Marc Marquez nuk zhvillon një sezon të plotë. Piloti spanjoll i Hondas u operua për të katërtën herë në tre vjetët e fundit, duke e mbyllur sezonin

para kohe. Tetë herë kampioni i botës në garat e motoçiklizmit do të jetë këtë fundjavë në Austri, në garën e radhës në MotoGP, jo për të garuar, por për të qenë pranë skuadrës dhe

parë modifikimet për sezonin e ardhshëm. Duke folur për operacionin që kreu në krahun e djathtë tre muaj më parë, ai shprehet: "Pas katër operacionesh, duket se situata

po shkon drejt rikuperimit total. Ky operacion i fundit duhet bërë, në të kundërt do të tërhiqesha nga garat. Objektivi im për të ardhmen ndoshta nuk do të jetë më fitimi i titullit

kampion, por dua të argëtohem duke pilotuar. Dua të pilotoj pa ndër dhimbje. Më pas, të shohim se deri ku mund të arrij", ka thënë Marc Marquez.





# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

## ANADRINIA MED

SHKOLLA E MESME E LARTË E MIJEKËSISË PRIZREN

Rr."JONI", nr. 47, 20000 Prizren, Kosovë, email: [anadriniamed@gmail.com](mailto:anadriniamed@gmail.com) / [kbiznesi@gmail.com](mailto:kbiznesi@gmail.com)  
Tel: +383 44/49 500 878 : +383 29 230 555

Bazuar në nenin 15 të Statutit, të SHMLM "ANADRINIAMED" Prizren, Këshilli Drejtues shpallë:

### KONKURS

#### **Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë Anadrinia MED shpall konkurs për pranimin e nxënësve të rinj në klasën e dhjet (X-të), për vitin shkollor 2022/2023**

Në drejtimin e licencuar për Arsimin e Mesëm të Lartë nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, si:

#### **- Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë**

Konkursi është i hapur nga date e shpalljes deri me datën 30.08.2022.

Të drejtën e konkurrimit e kanë të gjithë kandidatët të cilët e kanë të përfunduar shkollimin e mesëm të ulët dhe të cilët e kanë përfunduar me sukses testin e arritshmërisë.

Dorëzimi i dokumenteve nga kandidatët e interesuar duhet të bëhet në mënyrë fizike në ambientet e shkollës.

Kandidatët të cilët aplikojnë duhet t'i bashkëngjitin aplikacionit:

**Certifikatën e kalimit të testit të arritshmërisë për klasat e nënta (origjinale ose kopje të noterizuar);**

**Diplomën e shkollës së mesme të ulët (origjinale ose kopje të noterizuar);**

**Dëftesat e shkollës së mesme të ulët (origjinale ose kopje të noterizuar);**

**Certifikata e lindjes;**

**Dy fotografi;**

**Paraqitja e dokumenteve:** Rr."JONI", nr. 47, 20000 Prizren, Kosovë ose përmes e-mail: [anadriniamed@gmail.com](mailto:anadriniamed@gmail.com) / [kbiznesi@gmail.com](mailto:kbiznesi@gmail.com)  
Tel: +383 44/49 500 878 : +383 29 230 555

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Cats Recycler" Sh.p.k Vushtrri, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për objektin për riciklimin e katalizatorëve në Vushtrri.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 13.09.2022 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "Misini" në Vushtrri do të organizohet debat publik nga Kompania "Cats Recycler" Sh.p.k Vushtrri, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për objektin për riciklimin e katalizatorëve në Vushtrri.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/89740047502?pwd=Q3pzMjZ0V3lHUWRWd3pOM3NxTjJHQT09>

Meeting ID: 897 4004 7502

Passcode: 53ry6v

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Cats Recycler" Sh.p.k Vushtrri për objektin për riciklimin e katalizatorëve në Vushtrri.

[https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publikimet](https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publikimet)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Arber Gashi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

▶ Kushtrim Lezi shpall te pavlefshme certifikatën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

▶ Zejnije Morina shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHFMU "Mari Logoreci" Prizren

▶ Arbër Hana nga Gjakova shpal të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. "Mazllom Këpuska" Gjakovë nga kl. I,V dhe VI-IX.

▶ Valbone Hasani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës fillore "Yll Morina" Gjakovë nga kl. I-VIII.

▶ Albert Lekaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F. "Engjëll Gjoni" Novosell e Ulët.

▶ Angjelina Gojani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F. "Engjëll Gjoni" Novosell e Ulët.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

